

## I. HYRJE.

Subjekti Chemicals & Polymers sh.p.k është regjistruar pranë QKB në 12/12/2023, me numër NIPT-ti M33614202A. Vendi i ushtrimit të aktivitetit është në: Durrës, Maminas, Vlashaj, Autostrada Tiranë-Durrës, Zona Kadastrale 3796.

Objekti i veprimtarisë së subjektit është (citojmë sipas ekstraktit të QKB): *“Import-Eksport, transport, tregtim me shumice e pakice të mallrave industriale, ushqimore, ndertimore, bujqesore, pjese kembimi, materiale ndertimi, plehra kimik. Import, eksport dhe tregtim të materialeve të ndertimit si, gelqere, kolle, stuko, fino. Tregtimin dhe prodhimin me shumice të detaleve të çfaredo lloji materiali në përgjithësi për ndertimin, sjelljen e pajisjeve dhe atrecaturave për kantiere, të kryeje blerjen, shitjen, ndertimin, administrimin dhe shkëmbimin e pasurisë së palevizshme, Import- Eksport, transport, tregtim me shumice e pakice të mallrave industriale, ushqimore, ndertimore, bujqesore, pjese kembimi, materiale ndertimi, plehra kimik, tregtim materiale duralumini e druri. Import eksport, tregtim llaçrash, inerte, prodhime llaçrash të gatshme, të thate, të parapergatitura për ndertim dhe rruge, në thasë dhe rifuxho, me baze çimento, allçie, bitumi, koll, llaç, fino, bojak, stuko, bojra sintetike e natyrale me baze pigmentesh hekuri dhe atyre organike. Shit-blerje të pasurive të patundshme (toka, terrene, apartamente, dyqane, etj) dhe të tundshme. Laborator për realizimin e testeve kimike, provave laboratorike për materialet e ndertimit dhe bojerat.*

*Shoqëria mund të kryej cdo veprim, operacion apo transaksion tjetër komercial, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përmbushjes së objektit të shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mesiperme të mos jenë në kundërshtim dhe mos alterojnë objektin përsosur të veprimtarisë së shoqërisë. Prodhim të cdo lende të parë në fushën e ndertimit.”.*

Administratori i këtij subjekti është z. Adi Beti nga 30/01/2024 deri 30/01/2027.

Në bazë të ligjit Nr. 52/2020 Për disa ndryshime në Ligjin Nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuara, subjekti duhet të nënshtrohet procedurave për pajisje me leje mjedisi të tipit B, përkatësisht me:

**ID 7.12 Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve. Gërma r. Prodhimi i preparateve veshëse, llaqeve, bojrave dhe ngjitesve.**

Zhvillimi i këtij aktiviteti merr në konsideratë, identifikimin e ndikimeve të mundshme në mjedisin e punës dhe në afërsi të tij si dhe masat e nevojshme teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë, për të siguruar që kjo veprimtari të kryhet pa dëmtoar shëndetin e punonjësve si dhe, pa i sjellë dëme mjedisit të zonës të tilla si:

- Pa krijuar mundësi në cënimin e treguesve cilsor për ajrin, ujin, tokën, florën dhe faunën e zonës ku zhvillohet kjo veprimtari.
- Pa krijuar mundësi në gjenerimin e zhurmave dhe vibrimeve me intensitet jashtë normave urbane.
- Pa dëmtoar peisazhin.

Zhvillimi i qëndrueshmë i kësaj veprimtarie, vlerësuar nga pikëpamja e ruajtjes dhe e mbrojtjes së mjedisit, është rezultat i disa faktorëve, të cilët janë vlerësuar dhe mbajtur në konsideratë edhe për hartimin e këtij dokumenti.

Të tillë faktorë janë:

- Njohja dhe vlerësimi i dokumentacionit teknik që zotëron ky subject, për aktivitetin që vlerësohet në këtë dokumentacion.
- Njohja e gjendjen reale e zhvillimit të kësaj veprimtarije nga pikëpamja e ndikimit në mjedis.
- Analiza e faktorët pozitivë dhe negativë, që influencojnë në treguesit mjedisorë.
- Përcaktimi i masave teknike dhe organizative që duhen ndërmarrë për zbutjen dhe/ose eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.

## **II. PËRSHKRIMI I KUADRIT LIGJOR.**

- Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 16/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis” (i ndryshuar).
- Ligji nr. 10448 datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit”.
- Ligji nr. 10 440, datë 07.07. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” (i ndryshuar).
- Ligji nr.10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” (i ndryshuar).
- Ligji nr.10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” (i ndryshuar).
- V.K.M. nr. 435, datë 12.09.20020 “Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë”
- V.K.M. nr.177, datë 31.03.2005 “për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- V.K.M. nr. 402, datë 30.06.2021 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve”.
- V.K.M. nr. 587 datë 07.07. 2010 “ Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike”.
- VKM nr.419 datë 25.06.2014 “Për miratimin e kërkesave të posacme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipit A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit dhe të rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetentë deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB”.
- V.K.M. nr. 418, datë 25.06.2014 “Për grumbullimin diferencuar të mbetjeve në burim”.
- V.K.M nr. 686 datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave dhe përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit të deklaratës mjedisore”
- V.K.M. nr.1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”.
- Urdhrin e ministrit nr.146 datë 08.05.2007 “Për miratimin e listës së kuqe të florës dhe faunës”.
- Udhëzimin nr 8 datë 27.11.2007 “ Për nivelin kufi të zhurmave në mjedise të caktuara”.

### III. INSTALIMI DHE AKTIVITETI I TIJ.

#### 3.1. Vendi ku zhvillohet veprimtaria.

Objekti ku zhvillon veprimtarinë e tij Subjekti Juridik “Chemicals & Polymers” me NIPT M33614202A, është një ndërtesë me 1 (një) kat mbi tokë e ndërtuar posaçërisht, si objekt për instalimin e një linje teknologjike të prodhimit rezinash me bazë uji, e cila gjendet, në Durrës, Maminas, Vlashaj, Autostrada Tiranë-Durrës, Zona Kadastrale 3796.




Trualli mbi të cilën zhvillohet kjo veprimtari nuk ka asnjë lloj funksioni apo përdorimi veç atij në shërbim të kësaj veprimtarije. Ky truall, karakterizohet nga një sipërfaqe e pothuajse e zhveshur nga bimësia. Në të, nuk ka asnjë element infrastrukture. Ky truall përfshihet ndërmjet koordinatave të pasqyruara në tabelën në vijim.

X	Y
4382926.063	4582912.476
4382953.346	4582922.524
4382962.547	4582894.692
4382933.568	4582883.263

#### 3.2. Proçesi teknologjik.

Janë duke u instaluar dy linja teknologjike në këtë subjekt, vënia në punë e të cilave do të bëjë të mundur realizimin e proçeseve të suksesëshme teknologjike të prodhimeve të rezinave me bazë uji etj. Makineritë dhe pajisjet e instaluar janë, bashkëkohore kryesisht të importuara nga vendet e B.E.-së.

## SKEMA TEKNOLOGJIKE E LINJËS SË PRODHIMIT.



Në këtë linjë teknologjike janë instaluar këto pajisje:

- ① dhe ⑥ Reaktor 5 m<sup>3</sup>.
- ② dhe ⑦ Kondesator 20 m<sup>2</sup>.
- ③ dhe ⑧ Përzjerës i emulsionit 4 m<sup>3</sup>.
- ④ dhe ⑨ Përzjerës i katalizatorit 500 l.
- ⑤ dhe ⑩ Përzjerës i lëndës aktive 500 l.

**LOERMA SHPK**  
Laborator i Akredituar  
Gjithmone pranë jush!

Subjeti “Chemicals & Polymers” sh.p.k ka kryer investime të rëndësishme në instalimin e rrjeteve inxhinjerie brenda ndërtesës ku janë duke u instaluar këto linja teknologjike, të cilët influencojnë drejtpërsëdrejti në zhvillimin normal të kësaj veprimtarije.

Objekti ku zhvillohet kjo veprimtari është organizuar në disa ambiente pune, të lidhur dhe në funksion të njeri tjetrit. Ambientet e punës janë:

- Magazina e lëndës së parë;
- Dy linja teknologjike të prodhimit të rezinave me bazë uji etj.
- Magazina e depozitimit të prodhimit, në të cilën gjenden edhe pajisjet për ambalazhimin e tij.
- Magazina e peletave dhe kaldaja për ngrohjen e ujit;
- Ambientet hidro-sanitare;
- Ambientet e punës së personelit.

Veprimtaria prodhuese e kësaj linje teknologjike është e kushtëzuar nga sigurimi i lëndës së parë, me treguesit cilësor të përshtatshëm për prodhimin që synohet të arrihet. Është një proces teknologjik tërësisht i ri në vendin tonë dhe pritet të realizohet me ndihmën e specialistëve të huaj që kanë bërë projektimin e kësaj linje teknologjike.

Pajisjet dhe makineritë që janë duke u instaluar janë bashkëkohore dhe të prodhuara në vendet e BE. Këto makineri/pajisje do të instalohen mbi një platform metalike, e cila do të jetë rreth 2.5 metra mbi nivelin e dyshemesë. Në lartësinë rreth 6.3 metra do të jetë një tjetër platform metalike e cila do të shërbejë për inkastrimin e sigurtë të pajisjeve/makinerive teknologjike dhe njëkohësisht për lëvizjen e punonjësve që do të kontrollojnë dhe mbikqyrin punën apo zhvillimin e proceseve teknologjike.

Hipja/zbritja në këto platform pune, do të bëhet nëpërmjet dy palë shkallëve metalike, respektivisht për çdo njerën prej tyre.

Zhvillimi i proceseve teknologjike që do të jenë fiziko-kimike, do të jenë tërësisht të kontrolluara dhe të komanduara në mënyrë automatike nga njësitë kompjuterike që do të instalohen në dy hapsira enkas për to.

Prodhimi i realizuar në formën fizike, pluhur i ngurtë do të ambalazhohet në thasë letre të ngjashme me ambalazhet e çimentos duke qënë kështu i gatshëm për tregun e ndërtimit.

Kaldaja me vëllim 3 m<sup>3</sup> shërben për ngrohjen e ujit që do të jetë pjesmarrës në procesin teknologjik të prodhimit. Ky uji i ngrohtë do punojë në një sistem qarkullimi gjys të mbyllur, që nënkupton se ai ka mundësi të shtohet sa herë që shkarkojmë uji prej tij, duke ruajtur gjithnjë një sasi prej 15 m<sup>3</sup>. Ujrat teknologjikë që do dalin gjatë zhvillimit të procesit teknologjik, nëpërmjet rrjetit të tubacioneve do shkarkojnë në një vaskë dekantuese dhe prej saj në rrjetin e kanalizimeve të zonës TEDA.

### **3.3. Provat teknike të impjantit të prodhimit të rezinës me bazë uji**

Pas montimit të të gjithë pajisjeve teknologjike dhe tubacioneve e armaturave, i gjithë ky sistem do t'i nënshtrohet provës së qëndrueshmërive. Do bëhet mbushja graduale me ujë dhe presion deri në 23 kg/cm<sup>2</sup>. Nëse nuk ka rrjedhje uji dhe deformacione gjeometrike të pajisjeve dhe atrecaturave prova vlerësohet e suksesëshme. Gjatë kryerjes së provës do kontrollohet funksioni normal i pajisjeve dhe armaturave (valvolat e sigurisë, manometrat, nivelet, treguesit e tjerë teknikë etj.)

## IV. LËNDËT E PARA DHE ATO NDIHMËSE DHE, ENERGJITË E PËRDORURA OSE TË GJENERUAR NGA INSTALIMI.

### 4.1. Lëndët e para.

Solventi, është lënda bazë mbi të cilën mbështet zhvillimi i procesit teknologjik për prodhimin e rezinës me bazë uji. Solventi është një tretës (nga latinishtja *solvo*, "liroj, zgjidh") është një substancë që shpërndan një substancë të tretur, duke rezultuar në një tretësirë.

Tretësit gjejnë aplikime të ndryshme në industritë kimike, farmaceutike, të naftës dhe gazit, duke përfshirë në sintezat kimike dhe proceset e pastrimit.

Përveç përzierjes, substancat në një tretësirë ndërveprojnë me njëra-tjetrën në nivel molekular. Kur diçka tretet, molekulat e tretësit vendosen rreth molekulave të substancës së tretur. Transferimi i nxehtësisë është i përfshirë dhe entropia rritet duke e bërë tretësirën më të qëndrueshme termodinamikisht se sa substanca e tretur dhe tretësi veçmas. Ky rregullim ndërmjetësohet nga vetitë kimike përkatëse të tretësit dhe lëndës së tretur, të tilla si lidhja hidrogjenore, momenti dipol dhe polarizimi. Tretësira nuk shkakton një reaksion kimik ose ndryshime të konfigurimit kimik në lëndën e tretur. Megjithatë, tretshmëria i ngjan një reaksioni të formimit të kompleksit të koordinimit, shpesh me energji të konsiderueshme (nxehtësia e tretjes dhe entropia e tretësirës) dhe kështu është larg nga një proces neutral.

Tretësit mund të klasifikohen gjerësisht në dy kategori: polare dhe jopolare.

### 4.2. Lëndët ndihmëse.

Në këtë veprimtari nuk përdoren lëndë ndihmëse.

### 4.3. Prodhimi i realizuar.

Kohët e fundit po shikojmë që termi "rezinë" po përdoret gjerësisht në produkte ndërtimi, dekore etj.

Çfarë është rezina?

Rezina është një substancë me veti shumë të mira fizike, kimike dhe mekanike të cilën mund ta ndajmë në 2 kategori kryesore që janë: rezinat me origjinë bimore dhe rezinat sintetike ose në terma më të thjeshtë janë rezinat që prodhohen në fabrikë.

Rezina gjen përdorim në çdo ambient, që do të thotë që nuk ka kufizime për sa i përket përdorimit. Avantazhi kryesor i rezinës është realizimi i një sipërfaqe pa fuga, gjë që përkthehet në një dysheme antibakteriale e cila zë përdorim të gjerë në industrinë ushqimore dhe shëndetësore, aty ku higjena është kushti kryesor, deri në ambientet që kërkojnë diçka estetike, siç janë së fundmi bar-restoranet, shoëroomet, ambiente banimi, etj.

Gjatë procesit të tharjes, rezinat çlirojnë kimikate të cilat janë të dëmshme për shëndetin e njeriut nëse, nuk merren masat e duhura mbrojtëse. Në momentin që rezina thahet 100 % nuk përbën asnjë problem për shëndetin.

Ngjyrat dhe teksturat e realizuara janë të pafundme.

Rezina është një material me të cilin mund të realizosh çdo formë dhe çdo teksturë të mundshme, thjesht duhet një mendje kreative.

Rezina, si një risi e kohëve të fundit në Shqipëri, po zë përdorim të gjerë gati në çdo projekt arkitektonik.

#### **4.4. Energjitë që përdoren.**

Objekti ku do zhvillohet veprimtaria e prodhimit të rezinave me bazë uji, është i lidhur me rrjetin inxhinjerik dhe atë rrugor, të zonës ku ai gjendet. Pjesë të rëndësishme të rrjetit inxhinjerik janë, ai i:

- ✓ Furnizimit me energji elektrike.
- ✓ Furnizimit me ujë të pijshëm.
- ✓ Sistemi i kanalizimeve.
- ✓ Sistemi i tokëzimit.
- ✓ Sistemi i mbrojtjes nga zjarri.

##### **a. Furnizimi me energji elektrike.**

Furnizimi me energji elektrike bëhet nga rrjeti përkatës i kësaj zone, në bazë të kontratës me operatorin rajonal të shpërndarjes së energjisë elektrike. Energjia e nevojshme për furnizimin e pajisjeve të instaluara si dhe të sistemit të ndriçimit, merret nga kabina elektrike 6/0.4 kv, që gjendet në afërsi të këtij objekti. Shpërndarja e energjisë në pajisjet konsumatore të saj bëhet nga një panel komandues. Fuqia elektrike e instaluar është 75 kWh.

##### **b. Furnizimi me ujë.**

Furnizimi me ujë bëhet nga rrjeti përkatës i zonës në bazë të kontratës përkatëse me subjektin që administron rrjetin ujësjellës dhe atë të kanalizimeve të Bashkisë Durrës. Uji është pjesmarrës në procesin teknologjik të prodhimit të rezinës me bazë uji.

Uji do përdoret edhe për plotësimin e nevojat humane, larjen e ambienteve të punës etj.

Uji do të përdoret edhe për fikjen e zjarrit.

Për të garantuar furnizim të pandërprerë me ujë është instaluar një depozitë 10 m<sup>3</sup> e cila lidhet drejtpërsëdrejti me hidrantin e ujit me anë të tubacioneve prej çeliku dhe të një eletropompe. Sasia mesatare e konsumimit mujor të ujit pritët të jetë rreth 15 m<sup>3</sup>/muaj.

##### **c. Sistemi i kanalizimeve.**

Në objekt është ndërtuar një rrjet kanalizimesh i cili mbledh ujrë sipërfaqësore (ujrë të shirave) si dhe ujrë të zeza. Këto ujra shkarkojnë në rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza të kësaj zone.

##### **d. Sistemi i tokëzimit**

Për mbrojtjen e objektit në tërësi si dhe të pajisjeve të veçanta të tij nga shkarkimet atmosferike dhe ngarkesat elektrostatische, është instaluar një rrjet tokëzimi. Si element bazë të këtij rrjeti tokëzimi janë elektrodën e tokëzimit prej çeliku të zinkuar. Me këtë rrjet janë të lidhur të gjitha pikat e shkarkimit të objekteve që ngrihen mbi sipërfaqen e tokës.

##### **e. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri**

Investitori ka hartuar një projekt të veçantë për mbrojtjen nga zjarri si dhe është duke instaluar pajisjet e mbrojtjes nga zjarri të përcaktuara në këtë projekt. Në mënyrë të përmbledhur po tregojmë atë çfarë rekomandon të zbatohet projekti i MNZ-së.

Në këtë veprimtari për mbrojtjen nga zjarri është e nevojshme të duhet të zbatohen këto masa:

- Të vendosjen 4 (katër) fikseve dore ABC 6 kg, sipas përcaktimeve në vizatimet që i bashkangjiten këtij raporti.

- Të vendosjen 3 (tre) fikseve dore me shkumë 12 kg, sipas përcaktimeve në vizatimet që i bashkangjiten këtij raporti.
- Të instalohen 4 (katër) hydrante uji DN 20, sipas përcaktimeve në vizatimet që i bashkangjiten këtij raporti.
- Të bëhet instalimi i 4 (katër) dedektorëve të tymit sipas përcaktimeve në vizatimet që i bashkangjiten këtij raporti.
- Të bëhet instalimi i 2 (dy) dedektorëve të flake sipas përcaktimeve në vizatimet që I bashkangjiten këtij raporti.
- Të bëhet instalimi i një sistemi dhënie alarmi në të gjithë hapsirat punuese të subjektit (dhënësi i sinjalit të alarmit me dritë ose me zë si dhe një çelës/buton komandimi).
- Të bëhet instalimi i një sistemi të ndriçimit të emergjencës.
- Të bëhet instalimi i tabelave sinjalizuese dhe drejtuese të rrugëve të sigurta që mund të përdoren gjatë evakuimi, në rastet e emergjencës.

## V. BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.

Zhvillimi i pritshëm i aktivitetit të prodhimit të rezianve me bazë uji, pritet të krijojë mundësi për disa ndikimeve negative në zonën ku do zhvillohet kjo veprimtari si dhe në afërsi të saj.

### 5.1.Shkarkime në ajër.

Proçesi teknologjik i prodhimit të rezinës me bazë uji, përfshin disa proçese teknologjike gjatë zhvillimit të të cilëve pritet të ketë shkarkime në ajër, në mënyrë të veçantë gjatë proçesit të djegies së peletave në kaldajë. Uji i ngrohur në këtë kaldajë është pjesmarrës në zhvillimin normal të proçesit teknologjik të prodhimit të rezinës dhe, kështu sa kohë që linja teknologjike do të jetë në punë aq kohë do të punojë kaldaja. Nga oxhaku i saj do të shkarkohen në ajër, jashtë ndërtesës ku janë linjat teknologjike dhe kaldajë, gaze të produkteve të djegies së peletave prej druri, në ëprbërje të të cilavave do të jenë:

gaz karbonik (CO<sub>2</sub>), monoksid karboni (CO), dhe okside të azotit (NO<sub>x</sub>), si dhe avuj uji (H<sub>2</sub>O).

### 5.2.Shkarkime të ujërave të ndotur.

Proçeset teknologjike të këtij subjekti kërkojnë përdorimin e ujit. Kështu, sasia e ujit të përdorur nga ky subjekt është jo vetëm për plotësimin e kërkesave të proçesit teknologjik por, edhe për plotësimin e nevoja humane të punonjësve.

Nisur nga fakti se do kemi të bëjmë me zhvillim të proçeseve teknologjike në pajsje të mbyllura, nga ato nuk priten të shkarkohen ujra teknologjike.

Pritet të kemi shkarkim të ujërave që do të ndoten nga pluhurat dhe mbetje të tjera që mbartin gjatë pastrimit të ambienteve të punës si dhe ujëra të zeza.

### 5.3.Shkarkime në tokë.

Zhvillimi i kësaj veprimtarie shoqërohet me shkarkime të lëndëve të ngurta në tokë, të cilat janë në formë të mbetjeve të letrës, kartonit, plastikës etj.

Mbetje të letrës, kartonit, plastikës etj., çohen për çdo ditë në kazanët e mbetjeve urbane të zonës dhe largohen prej andej për në lëndfillin e qytetit nga një subjekt i kontraktuar nga bashkia Durrës.

#### 5.4.Shkarkime të zhurmave.


Gjatë punës të pajisjeve/makinerive që kryejnë proçese të ndryshme teknologjike, në afërsi të këtyre makinerive/pajisjeve (në vendet e punës) janë të pranishme zhurmat. Nga matjet e kryera nga ekspertët e fushës, rezulton se intensiteti i këtyre zhurmave nuk kalon 80 dBA.

### VI. KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE, RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES.

Veprimtaria që vlerësohet në këtë raport, gjendet në Maminias, Vlashaj, Autostrada Tiranë-Durrës, Zona Kadastarle 3796 dhe ndodhet në administrimin e Bashkisë Durrës.

Bashkia Durrës është një nga bashkitë më të mëdha të vendit tonë e vlerësuar kjo si nga shtrirja apo madhësia e teritorit që ajo administron me një sipërfaqe prej 430 km<sup>2</sup> ashtu edhe nga popullsia, prej rreth 215000 banorë.

Bashkia Durrës shtrihet nga kepi i Rodonit në veri-perëndim deri tek Prroi i Agait pas shkëmbit të Kavajës në jugperëndim. Teritori i kësaj bashkie kufizohet me:



- Bashkinë Kurbin në Veri,
- Bashkitë Krujë, Vorë dhe Shijak në Lindje,
- Bashkitë Tiranë dhe Kavajë në jug dhe juglindje.

Bashkia e Durrësit është pjesë e Qarkut të Durrësit dhe përbehet nga 6 njësi administrative: Durrës, Sukth, Ishëm, Katund i Ri, Rrashbull dhe Manëz. Në përbërje të tyre këto njësi administrative përfshijnë gjithsej 3 qytete dhe 40 fshatra.

Drejtuesit dhe administrata e kësaj bashkie, i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë problemeve mjedisore me të cilat ndeshen, dhe kjo pasqyrohet në analiza dhe projekte të përfshira në planet e zhvillimit të kësaj bashkije. Analizat e treguesve mjedisorë janë pjesë e rëndësishme analitike e dokumentave të tillë si *Plani i zhvillimit të Bashkisë Durrës*, *Strategjia teritoriale e Bashkisë Durrës* etj.

i. Përshkrim të faktorëve klimatike.

Teritori që administrohet nga Bashkia Durrës është tërësisht bregdetar. Deti ndikon në klimën e këtij rajoni duke mundësuar qarkullimin e masave ajrore të Adriatikut dhe të Mesdheut. Veprimtaria e njeriut, që në Durrës është shprehur me ndërhyrjet në natyrë si: tharja e kënetës, c'pyllëzimi në zonat kodrinore, ndërtimi i ujëmbledhësve apo ngritja e objekteve industriale, etj., ka kontribuar në tiparet klimaterike.

Durrësi ka një klimë tipike mesdhetare, me verë të lagësht dhe dimër të butë. Temperaturat mesatare variojnë nga rreth 5°C në janar dhe rreth 28°C në korrik dhe në gusht. Muajt më të nxehtë dhe më thatë të vitit janë qershori, korriku dhe gushti.

Element tjetër i klimës janë vranësirat apo ditët me shi. Numri mesatar i ditëve të vranëta apo me shi është gati 90 ditë/vit.

Erërat janë një element me rëndësi të madhe gjeografike dhe agrometeorologjike për ultësirën perëndimore. Erërat që ndihet në Durrës janë Murrai, Shiroku dhe Juga. Erërat karakteristike për Durrësin janë brizat. Gjatë verës në Durrës ka rreth 71 ditë me briza, kurse në dimër 18 ditë. Numri mesatar vjetor është 191 ditë. Në përputhje me motin briza fillon nga ora 9-10 paradite dhe vazhdon deri në 16-18 pasdite. Shpejtësia mesatare e saj në mesdite është 4-6 m/s.

Reshjet e borës janë një dukuri e rrallë në Durrës dhe, në zonën fushore e kodrinore të këtij rrethi.

ii. Peisazhi dhe Topografia.

Peisazhi dhe Topografia e zonës në të cilën zhvillon aktivitetin e tij ky subjekt, është ai i një zone rurale të banuar, e cila vitet e fundit ka një zhvillim të vlersuar duke u shndërruar gradualisht në një zonë urbane.

Është e rëndësishme të theksojmë se zhvillimi i pritëshëm i kësaj veprimtarije nuk do të shoqërohet me tjetërsim total të truallit. Ai do të përdoret për zhvillimin e përrindërtimin e infrastrukturës së nevojshme, inxhinjerie të subjektit.

Gjithashtu, duhet të theksojmë se ushtrimi i këtij aktiviteti nuk prek apo cënon zonat të mbrojtura me ligj si:

- ✚ rezervate kombëtare natyrore;
- ✚ zona me interes shkencor të veçantë;
- ✚ parqet kombëtare;
- ✚ zonat me bukuri të rrallë natyrore;
- ✚ zonat ujore të mbrojtura;
- ✚ zonat e mbrojtura;
- ✚ ndërtimet me vlera;
- ✚ monumente të lashtësisë;
- ✚ zonat me rëndësi arkeologjike, turistike, etj.

iii. Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit.

Sistemi ujor është tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujore, që përmbajnë të gjithë trupat ujorë, përfshirë brigjet sipas përcaktimeve të legjislativës të posaçëm. Sistemi ujor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës "ujë". Sistemi i ujrave në Bashkinë Durrës përbëhet nga ujrat detare, ato të lumenjve dhe të përrenjve, ujrat sipërfaqësore (kryesisht rezervuarët) dhe ato nëntokësore (*aquifer*). Këtu mund të përfshijmë dhe ujrat e përdorura të destinuara për shkarkim ose riciklim (total ose të pjesshëm).

**Lumi** më i rëndësishëm që përshkon Bashkinë Durrës është Erzeni (lumi Ishëm prek pak fshatin Gjericaj në kufi me Krujën). Zona e tij ujëmbledhëse është kryesisht në Malin e Kërrabës dhe në

malësinë e Tiranës. Erzeni ushqehet nga disa burime nëntokësore por mbi të gjitha nga reshjet e shiut. Ky profil, i inkurajuar dhe nga ndryshimet klimaterike, nga shpyllëzimi i shpateve të zonave ujembledhëse të Krrabës dhe malësisë së Tiranës si dhe nga ndërtimet në luginën e lumit, kanë rritur amplitudat e shkarkimit. Si pasojë probabilitetit i prekjës i zonës urbane nga Erzeni është rritur. Ndryshimin e prurjeve të lumit e ndjen dhe bujqësia dhe hortikultura. Por rëndësi shumë të madhe ka impakti që përmbytjet eventuale mund të kenë në sistemet e ujit të pijshëm, ndotje e aquifereve dhe në shkarkimet.

Rajoni i Durrësit është i pasur në ujra sipërfaqësore në formën e *rezervuareve*, kryesisht për mbledhjen e reshjeve të shiut dhe përdorimin e tyre për vaditje. Ato gjenden në pjesen veriore të territorit të bashkisë në kodrat e Ishmit dhe të Manzës. Ndër më të rëndësishmit janë: liqeni i Topanës në kodrat e Ishmit; liqeni i FushKrujës që gjendet në kufi të Shkafanës dhe që shtrihet në bashkinë e Durrësit dhe atë të Krujës; dhe liqeni i Manzës që është më i vogli. Vitet e fundit këto liqene janë kthyer në vëmendjen e banorëve të zonës, kryesisht për aktivitete sporadike turizmi dhe për rritjen e peshkut të ujrave të ëmbla. Potenciali i tyre turistik dhe si rezervë ujore është i nënshrytëzuar.

Duke vërejtur zonën ku do të investohet shikohet një prani e ujrave nëntokësore dhe jo e atyre mbitokësore në prani të objektit. Burimi ujor më i afërt është 1.49 km larg.

iv. Flora dhe fauna e kësaj zone përbëhet nga ajo e butë që trajtohet nga banorët si dhe ajo e egër.

Rajoni i Durrësit shquhet për një diversitet biologjik e peizazhor të pasur. Në origjinë të këtij diversiteti qëndrojnë pozicioni gjeografik, faktore gjeologjike, pedologjike, hidrologjike, relievi dhe klima. Diversiteti i lartë i ekosistemeve dhe habitateve (ekosisteme detare, bregdetare, laguna e vende të lagëta, delta lumenjsh, duna ranore, liqene, lumenj, shkurreta medhetare, pyje halore dhe të përzierë), ofron një larmi të pasur llojesh bimore të pasur, kryesisht mesdhetare, e cila pasqyrohet më së miri dhe në zonën e mbrojtur të këtij rajoni.

Na duhet të pohojmë se zona apo rajoni i Manzës nuk mund të vlerësohet për prani në të, të një diversiteti ekosistemesh dhe habitatesh. Kjo për faktin se në të ka ndërhyrje të dukëshme njerzore si në aspektin e zhvillimeve bujqësore, prerjen e shkurreve dhe drurëve natyror ashtu edhe në ndërtimin dhe funksionimin e linjave teknologjike të prodhimeve të ndryshme etj.

Nga pikëpamja vegjetacionit apo ajo floristike, rajoni i Durrësit bën pjesë në zonën e shkurreve mesdhetare, të përfaqësuara nga dafina, shqopa dhe nga shkurre të tjera në formën e kaçubeve të veçanta. Konditat klimatike të zonës lejojnë të zhvillohet një bimësi e shumëllojshme që nga pishat, plepi, frashëri i zi, morina, palma dhe dafina, deri në bimët e tjera dekorative si : frashëri gjethengushtë, vërria, eukalpti, shelgu lotues, etj. të ruajtura në forme natyrale. Në zonat më të larta të rajonit kryesisht në zonën e Shijakut, Maminasit, Katundi te Ri dhe Ishmit rriten gjethe delli, lulebasami, hithra, grami, rrodhja, netulla, bar pate etj.

Përveç bimësisë pyjore që zë një vend të rëndësishëm në bimësinë e kësaj zone, po kaq rëndësi kanë edhe kulturat bujqësore të përfaqësuar nga : gruri, misri, fasulja, ulliri, lule dielli, etj.

Zhvillimi i faunës është i lidhur si me kushtet e përgjithshme të zonës, siç është klima, por kryesisht edhe nga kushtet e zhvillimit florës. Pjesa e faunës tokësore përfaqësohet me kafshë si: Canis aureus (fam. Canidae), lepuri i egër, Oryctolagus cuniculus (fam. Leporidae) si dhe nga disa kafshë shtëpiake si lopë, derra, dele, dhi, etj. Amfibët dhe zvarranikët janë të shumtë dhe mund të përmendin bretkocën Rana dalmatica, gjarprin Vipera ammodytes, zhapinj të Lacerta spp. etj.

## VII. NATYRA DHE SASITË E SHKARKIMEVE TË PRITSHME NGA INSTALIMI NË ÇDO VEND/MJEDIS, SI DHE IDENTIFIKIMI I EFEKTEVE TË RËNDËSISHME TË SHKARKIMEVE NË MJEDIS.

Zhvillimi i pritshëm i aktivitetit të prodhimit të rezianve me bazë uji, pritet të krijojë mundësi për disa ndikimeve negative në zonën ku do zhvillohet kjo veprimtari si dhe në afërsi të saj. Në kapitullin e V-të të këtij dokumenti, përshkruam shkarkimet e pritëshme në ajër, ujë dhe tokë, nga zhvillimi i kësaj veprimtarije.

### 7.1. Natyra dhe sasitë e shkarkimeve të pritëshme, në mjedis.

#### *a. Shkarkime në ajër.*

Proçesi teknologjik i prodhimit të rezinës me bazë uji, përfshin disa proçese teknologjike gjatë zhvillimit të cilëve pritet të ketë shkarkime në ajër, në mënyrë të veçantë gjatë proçesit të djegies së peletave në kaldajë. Uji i ngrohur në këtë kaldajë është pjesmarrës në zhvillimin normal të proçesit teknologjik të prodhimit të rezinës dhe, kështu sa kohë që linja teknologjike do të jetë në punë aq kohë do të punojë kaldaja. Nga oxhaku i saj do të shkarkohen në ajër, jashtë ndërtesës ku janë linjat teknologjike dhe kaldajë, gaze të produkteve të djegies së peletave prej druri, në ëprbërje të cilavave do të jenë:

Gaz karbonik ( $\text{CO}_2$ ), monoksid karboni (CO), dhe okside të azotit ( $\text{NO}_x$ ), si dhe avuj uji ( $\text{H}_2\text{O}$ ). Duke vlersuar me kujdes, sasinë dhe treguesit cilësor të këtyre gazeve, mund të pohojmë se ato nuk janë gaze mbetës në atmosferën e zonës ku shkarkohen. Ato janë gaze lehtësisht të tretshëm në ajër, duke ulur ndjeshëm përqëndrimin e tyre në një kohë relativisht të shkurtër.

#### *b. Gjenerimi i zhurmave.*

Gjatë punës të pajisjeve/makinerive që kryejnë proçese të ndryshme teknologjike në afërsi të këtyre makinerive/pajisjeve (në vendet e punës) pritet të jenë të pranishme zhurmat. Subjekti duhet të kryej matjet e intensitetit të tyre jo vetëm në vendet e punës por, edhe jashtë tyre nga ekspertët e fushës, laboratorë të akredituar. Ne vlersojmë se pajisiet/makineritë e instaluar të ardhura nga BE do të jenë miqsore me mjediset e vendeve të punës sa i takon nivelit të zhurmave të gjeneruara. Gjithsesi, me vënien në punë të tyre dhe, kryerjen e matjeve respektive do të dalin përfundimet konkrete mbi këtë element ndotës të mjedisit.

#### *c. Shkarkime të ujërave të ndotur.*

Proçeset teknologjike të këtij subjekti kërkojnë përdorimin e ujit. Kështu, sasia e ujit të përdorur nga ky subjekt është jo vetëm për plotësimin e kërkesave të proçesit teknologjik por, edhe për plotësimin e nevoja humane të punonjësve.

Nisur nga fakti se do kemi të bëjmë me zhvillim të proçeseve teknologjike në pajisje të mbyllura, nga ato nuk priten të shkarkohen ujra teknologjike.

Pritet të kemi shkarkim të ujërave që do të ndoten nga pluhurat dhe mbetje të tjera që mbartin gjatë pastrimit të ambjenteve të punës si dhe ujëra të zeza. Këto ujra të ndotur do të shkojnë në një vaskë dekantimi para shkarkimit të tyre në kolektorin e ujërave të ndotur të kësaj zone industrial. Ujrat e zeza do të shkojnë në kolektorin e tyre të shkarkimit.

**d. Shkarkime të mbetjeve të ngurta teknologjike dhe mbetjeve urbane.**

Nga zhvillimi i kësaj veprimtarije nuk pritet të ketë shkarkime në tokë të mbetjeve të ngurta teknologjike. Por, do të kemi krijimin e mbetjeve të ngurta urbane në përbërje të cilave do jenë ambalazhet e letrës, kartonit, plastikës etj.

Mbetje të letrës, kartonit, plastikës etj., çohen për çdo ditë në kazanët e mbetjeve urbane të zonës dhe largohen prej andej për në lëndfillin e qytetit nga një subjekt i kontraktuar nga bashkia Durrës.

**e. Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet projekti.**

Nuk vlersohen ndikime negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet kjo veprimtari. Në këtë objekt kanë përfunduar ndërhyrjet fizike për ndërtime godinash, rrjetesh inxhinjerike, rrugësh etj.

Në periudha të përcaktuara, do kryhen punime për mirëmbajtjen e këtyre ndërtimeve inxhinjerike, sigurisht mbështetur në lejet ndërtimore të miratuara nga pushteti vendor.

**f. Ndikimet negative në habitatet dhe biodiversitetin e zonës ku zhvillohet projekti.**

Nga zhvillimi i këtij aktiviteti nuk dëmtohet flora dhe fauna e rrezikuar e cila është përcaktuar në V.K.M-në Nr. 804.dt. 04.12.2003.

Zona që shfrytëzohet nuk përfaqëson zonë me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për “Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme” për t’u shpallur “Peizazh i mbrojtur”.

**g. Ndikime sociale nga zhvillimi i projektit të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe burimeve të tjera natyrore si dhe, shqetësime që mund të lindin nga ndikimet në mjedis për shkak të shkarkimeve të ndryshme, zhurmave, rënies së zjarreve etj.**

Zhvillimi i këtij aktiviteti nuk ka kërkuar dhe nuk do të kërkojë përdorimin e tokës shtesë veç asaj të miratuar për shfrytëzim.

Probabiliteti i ndodhjes për secilin nga rastet e mësipërm do të varet shumë nga masat mbrojtëse që janë parashikuar të zbatohen.

Zhvillimi i aktivitetit të prodhimit të rezinës me bazë uji, nuk pritet të shoqërohet me aksidente mjedisore të cilat mund të sjellin pasoja të dëmshme në treguesit cilësorë të mjedisit të vendit ku ponohe dhe në afërsi të tij si:

- ndotje të ujrave nga lëndë të rrezikshme.
- emetime në ajër të gazeve helmuese.
- kontaminim të tokës.

## **7.2 Karakteristikat e ndikimeve negative dhe efektet e rëndësishme të tyre në mjedis.**

**a. Vlerësimi i ndikimeve.**

Proçesi i vlerësimit të ndikimeve negative në mjediset e vendeve të punës dhe në zonën rreth tyre, është i lidhur me kryerjen e një sërë njohjesh dhe vlerësimesh të tilla si:

- Njohja e vlerave natyrore dhe mjedisore të zonës.
- Njohja me infrastrukturën inxhinjerike egzistuese dhe me nevojën për plotësim të saj me infrastrukturë të re në plotësim të kërkesave që parashtron projekti që zbatohet.

- Njohja me lëndët e para dhe ato ndihmëse si dhe me energjitë e nevojshme që përdoren për zbatimin e projektit.

Mbështetur mbi këto të dhëna bazë si dhe në treguesit e pritshëm mjedisor nga zhvillimi i veprimtarisë prodhuese të këtij subjekti, ekspertë të fushave të ndryshme bënë përpjekje për të përcaktuar vlerësimet e identifikuar. Vlerësimi i kryer ka të bëjë me efektet e tyre të drejtpërdrejta apo të tërthorta në treguesit cilësor të mjedisit, në zonën ku zhvillohet projekti dhe është një nga fazat më të rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse:

- Tregon llojin, elementët dhe kohë zgjatjen e çdo lloji ndikimi të identifikuar.
- Përafron ato me objektivitë me tërësinë e bashkëveprimeve të tyre me parametrat mjedisor të zonës ku zhvillohet projekti.

Kriteret e përdorur për vlerësimin e ndikimeve variojnë dhe përcaktohen nga faktorë të përcaktuar dhe, rezultatet e arritura drejtohen kryesisht ndaj përmirësimeve më të mundshme të vlerave të mjedisit të ndikuar.

#### **b. Shtrirja fizike e ndikimeve negative.**

Ky parametër vlerëson sipërfaqen apo dimensionet hapësinore të shtrirjes së një ndikimi të përcaktuar e vlerësuar në raport me burimin që gjeneron këtë ndikim.

#### **c. Kohëzgjatja e ndikimeve negative.**

Ky parametër vlerëson periudhën kohore se sa mund të zgjasë një ndikim i caktuar në dimensionin kohor dhe kështu mund të kemi ndikim të përhershëm/mbetës apo ndikim të përkohshëm.

#### **d. Kthyeshmëria.**

Ky parametër vlerëson të gjitha mundësitë e kthimit të mjedisit të ndikuar, në gjendjen e tij të mëparshme apo/ose aftësitë për rehabilitimin dhe regjenerimin e plotë të mjedisit të ndikuar.

#### **e. Rëndësia.**

Ky parametër realizon një vlerësim total të të gjithë përmasave të mësipërm dhe njëkohësisht thekson e rekomandon drejtimit më të rëndësishme që duhet ndjekur dhe zbatuar nga drejtuesit e subjektit, për të administruar saktësisht çdo lloj ndikimit të identifikuar.

#### **f. Llojet e ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jodirekte).**

Ndikimet e identifikuar nga zhvillimi i aktivitetit të rezinës me bazë uji, do të jenë ndikime të drejtpërdrejta në mjedis.

Në përfundim ne vlerësojmë se të gjithë llojet e ndikimeve në mjedis të përshkruara në këtë kapitull do të jenë ndikime të përkohshme, jo mbetëse në treguesit e cilësisë së ajrit, të ujrave ku shkarkohen dhe të tokës. Kohëzgjatja e tyre është relativisht e shkurtër ashtu siç është e kufizuar edhe mundësia e shtrirjes së tyre në mjediset jashtë zonës ku zhvillohet kjo veprimtari.

### **VIII. TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME.**

Duke vlerësuar në tërësi, të dhënave teknike të pajisjeve dhe sistemeve të instaluar në këto dy linja teknologjike si dhe parametrat teknologjikë të proceseve që do të zhvillohen deri në marrjen e produktit përfundimtar, jemi të mendimit se kemi të bëjmë me teknologji dhe pajisje bashkëkohore të importuara nga vende të BE-së.

Vënia plotësisht në punë e tyre dhe shfrytëzimi për një periudhë relativisht të gjatë kohe, duke kryer në mënyrë periodike monitorimet respektive për shkarkimet në ajër, ujë dhe tokë, minimalisht çdo gjashtë muaj, do të reflektojnë rezultate, analizat e të cilave duhet të dëshmojnë për:

- i. Përputhshmërinë e plotë apo të pjesëshme të punës së tyre me linjën teknologjike si dhe kërkesat e standartit për shkarkimet në mjedis;
- ii. Nevojën për ndryshime të parametrave teknologjik apo për ndryshime konstruktive.

Vlerësimi i përgjithshëm dhe i vijueshëm, i zhvillimeve teknologjike në këtë veprimtari pritet të dëshmojë se të gjitha llojet e shkarkimeve janë të përkohëshme. Treguesit cilësor të lëndëve që shkarkohen si dhe sasitë respektive të secilës prej tyre nuk pritet të kenë influenca mbetëse në treguesit cilësorë të mjedisit dhe nuk pritet që të çojnë në përkeqësim të treguesve cilësorë aktualë të mjedisit.

### **IX. ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR.**

Disa prej përparësive më të rëndësishme në zgjedhjen e këtij trualli po i pasqyrojmë në vijim:

- a. Kjo zonë është e lidhur organikisht me rrjetin rrugor kombëtar.
- b. Në qytetin e Durrësit gjenden lehtësisht persona të kualifikuar për të kryer proceset e punës, të programuara nga kjo veprimtari.

Pajisjet e instaluar si dhe parametrat teknologjikë me të cilët punojnë këto pajisje, besojmë se janë bashkëkohore, nisur nga fakti që ato vijnë nga vende të BE-së.

### **X. MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME).**

Drejtuesit teknik dhe ligjor të subjektit i kanë kushtuar vëmendje maksimale njohjes së mundësive të krijimit të mbetjeve të ngurta teknologjike dhe të atyre urbane. Në vijim po përshkruajmë mënyrat apo procedurat që priten të zbatohen në trajtimin e mbetjeve të krijuara.

- a. Mbetje e teknologjike të ngurta që dalin gjatë proceseve teknologjike.

Gjatë zhvillimit të procese teknologjike në këtë subjekt nuk pritet të ketë gjenerim të mbetjeve të ngurta.

- b. Mbetje urbane të cilat përbëhen nga ambalazhe të letrës, kartonit, plastikës, qelqit, drurit, mbetje ushqimore nga veprimtaria njerëzore etj.

Mbetje të letrës, kartonit, plastikës etj., çohen për çdo ditë në kazanët e mbetjeve urbane të zonës dhe largohen prej andej për në lëndfillin e qytetit nga një subjekt i kontraktuar nga bashkia Durrës.

## **XI. MASAT PËR PËRDORIMIN EFIÇENT TË ENERGJISË.**

Të gjitha makineritë, pajisjet e instaluara në këtë subjekt janë blerë në vende të Bashkimit Europian. Janë pajisje bashkëkohore me sisteme të komandimit të automatizuar të punës së tyre, nëpërmjet instalimit të një njësie elektronike “trurit” komandues të sejcilës linjë teknologjike më vete. Kështu, çdo njëra prej linjave teknologjike punon sa kohë është e nevojshme dhe gjatë gjithë kohës tjetër qëndron pa punuar pa cënuar punën e pajisjeve dhe makinerive të linjës tjetër. Kjo mënyrë shfrytëzimi bën të mundur kontrollin rigoroz të punës së tyre dhe për rrjedhojë edhe një konsum energjije të kontrolluar në nivelet më të pranushme. Të gjitha këto dëshmojnë për një punë normale të elektromotorëve që vënë në lëvizje këto pajisje dhe për shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.

Sistemi i ndriçimit të ambjenteve të punës është i plotësuar me pajisje ndriçimi ekonomike, duke krijuar edhe këtu kushte për një shfrytëzim eficient të energjisë elektrike.

## **XII. MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:**

- a. Janë marrë masat e nevojshme për të parandaluar aksidentet dhe për të kufizuar pasojat e tyre.

Subjekti ka një periudhë relativisht të gjatë kohe që përgatitet të fillojë këtë veprimtari, për shfrytëzimin e linjave teknologjike përkatëse. Gjatë kësaj periudhe kohore, stafi administrativ dhe teknik është marrë me rekrutimin e personelin punonjës si dhe trajnimin e tij për njohjen e pajisjeve të instaluara, përdorimin e tyre, njohjen e procesit teknologjik dhe, të lëndëve të para dhe të atyre ndihmëse si dhe të produktit që pritet të merren. Pjesë e këtyre trajnimeve janë edhe njehja me rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes në punë, mbrojtjes nga zjarri, mbrojtjes së mjedisit etj.

Janë hartuar rregullat për shfrytëzimin e këtyre makinerive dhe pajisjeve teknologjike si dhe ato të mbrojtjes në punë. Krahas tyre janë hartuar edhe Projektet e nevojshme të mbrojtjes nga zjarri, Programi i vlersimit të rrisqeve të mundëshme në punë etj.

Ne vlerësojmë se është e nevojshme rivlersimi i këtyre rregulloreve haps pas hapi me fillimin e shfrytëzimit të linjave teknologjike apo vënien në punë të tyre.

- b. Janë ndërmarrë masat e nevojshme, me ndërprerjet definitive të aktiviteteve, për të shmangur ndonjë rrezik të ndotjes dhe kthimin e vendit të operimit në gjendje të kënaqshme.

Është kryer një investim i rëndësishëm në disa drejtime si, në infrastrukturën inxhinjrike (ndërtesë, rrjete inxhinjrike etj) instalimin e linjave teknologjike dhe në trajnimin e personelit punonjës.

Të gjitha këto me idenë e një zhvillimi të qëndrueshëm, si nga ana finaciare ashtu edhe në prespektivën kohore të zhvillimit të tij. Drejtuesit e subjektit nuk mendojnë akoma për të vlerësuar ndërprerjen e zhvillimit të këtij aktiviteti dhe për këtë arsye nuk kanë hartuar programet që do të zbatohen për mbylljen e kësaj veprimtarije.

Në përgjigje të kërkesave të këtij kapitulli, në vijim po pasqyrojmë disa prej drejtimeve më të mira të mundëshme, që duhen vlerësuar, analizuar dhe zbërthyer në një plan të detajuar nga drejtuesit e subjektit. Ato duhet të vlerësojnë gjithashtu edhe përcaktimet që do të përshkruhen në lejen e mjedisit, të cilat kanë lidhje me këtë kapitull.

Mbyllja përfundimtare ka kërkesa më rigorozë të cilat kërkojnë gjithashtu procedura të përcaktuara saktësisht, për çdo stad zhvillimi të proceseve që duhen kryer për mbylljen e aktivitetit. Kështuqë, kërkohen studime të plota nga grupe inxhinjerësh apo ekspertësh të fushave të ndryshme, të kryera në përputhje me kërkesat e legjislacionit finciar, mjedisor, të administrimit të teritorit, të efekteve sociale etj. Krahas kryerjes së këtyre studimeve, duhet të pregatitet dokumentacioni përkatës për marrjen e lejeve të nevojshme, si psh vendi ku do hidhen mbeturinat që krijohen, metalike, plastike gome, druri, vajrash, inertesh etj. Çdo të bëhet me truallin pas lirit të tij, do të vijojë të qëndrojë si një truall për përdorim industrial apo do përshtatet për veprimtari të tjera!?

Duke vlerësuar kërkesat e kësaj rubrike, ne mund të pohojmë se ndërpreja e kësaj veprimtarije nuk sjell pasoja në ndjeshme në treguesit mjedisor të zonës ku ai zhvillohet.

Nëse mbyllet kjo veprimtari atëherë do të hiqen të gjitha pajisjet e instaluar. Godina do të qëndrojë në gjendjen e tanishme apo mund të përshtatet rishtas për zhvillimin e ndonjë aktiviteti tjetër.

Laborator i Akredituar  
Gjithmone pranë jush!

### **XIII. MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.**

Monitorimet duhet të kryhen nga laboratorë të akredituar për vlerësimin e shkakrimeve në mjedis, në përputhje me kërkesat e legjislacionit respektiv, për shkarkimet në ajër dhe nivelin e zhurmave.

<b>Parametri</b>	<b>Frekuenca e monitorimit</b>	<b>Aksesi në vendodhjet e matjeve.</b>
Llojet e gazeve të shkarkuar dhe përqëndrimi i tyre.	Çdo 6 muaj	Oxhaku i kaldajës.

Treguesit cilësor të ujrave të shkarkuar.	Çdo 6 muaj	Kolektori i shkarkimit të ujrave të ndotur (pas vaskës së dekantimit)
Niveli i zhurmave.	Çdo 6 muaj	Në vendin e punës ku janë instaluar pajisjet teknologjike që gjenerojnë zhurma

**-FUND-**

*Ernal Bani*



**Loerma SHPK**  
NIPT: L02928204T

**LOERMA SHPK**

Laborator i Akredituar  
Gjithmone pranë jush!

## KONTRATË QIRAJE

Sot, më datë 27 / 10 / 2025, në Durres, lidhet kjo kontratë qiraje ndërmjet:

### I. QIRADHËNËSI

**Shoqëria DEUTSCHCOLOR sha**, me seli ne Durres Maminas VLASHAJ Autostrada Tiranë – Durrës, Zonë Kadastrale 3796, regjistruar si person juridik, me NIPT **L21326504J**, me administrator **z.Danjel Cfarku**, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr.Personal I90714080D dhe **z.Arijan Curri**, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr.Personal J50320085M

dhe

### II. QIRAMARRËSI

**Shoqëria “Chemicals & Polymers shpk”**, një shoqëri shqiptare, regjistruar në Regjistrin Tregtar, Qendra Kombetare e Biznesit, me numër identifikimi M33614202A, me adresë : Autostradac Tirane – Durres, Maminas, Vlashaj, përfaqësuar nga administratori Z.Adi Beti, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së ID me numër personal J111300611

Qiradhënësi dhe Qiramarrësi, më poshtë të quajtur bashkërisht “Palët”, bien dakord si vijon:

#### Neni 1 – Objekti i kontratës

1.1 Qiradhënësi i jep me qira Qiramarrësit një pjesë të ambienteve të tij, me sipërfaqe rreth 300 m<sup>2</sup>. të ndodhura në pasurinë me nr.334/65, ZK 3796, truall me sipërfaqje 17525 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 7196 m<sup>2</sup>.

1.2 Ambientet jepen me qira për përdorim ekskluziv nga Qiramarrësi, në përputhje me kushtet e kësaj kontrate.

#### Neni 2 – Destinacioni dhe përdorimi i ambienteve

2.1 Qiramarrësi do t'i përdorë ambientet për ushtrimin e veprimtarisë së tij ekonomike, në përputhje me objektin e aktivitetit të regjistruar dhe me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

2.2 Ushtrimi i aktivitetit në ambientet objekt i kësaj kontrate do të bëhet në mënyrë të tillë që të mos pengojë, cenojë apo kufizojë ushtrimin e aktivitetit të Qiradhënesit.

2.3 Ndryshimi i destinacionit të ambienteve lejohet vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të Qiradhënesit dhe në përputhje me legjislacionin përkatës.

### Neni 3 – Afati i kontratës

3.1 Kjo kontratë lidhet për një afat fillestar prej një (1) viti, duke filluar nga data 27/10/2025 deri më 26/10/2026.

3.2 Në përfundim të afatit fillestar, kontrata rinovohet automatikisht për një (1) vit tjetër, nëse asnjëra palë nuk njofton me shkrim për të kundërtën së paku 60 ditë para skadencës.

3.3 Çdo rinovim pas afatit të dytë ose ndryshime të tjera mund të bëhen vetëm me marrëveshje të shkruar ndërmjet Palëve.

### Neni 4 – Çmimi i qirasë dhe kushtet e pagesës

4.1 Qiraja mujore është 200 000 lekë (me TVSH).

4.2 Pagesa kryhet brenda datës 5 të çdo muaji, në llogarinë bankare të Qiradhënesit.

### Neni 5 – Gjendja dhe mirëmbajtja e ambienteve

5.1 Qiramarrësi deklaron se i ka inspektuar ambientet dhe i pranon ato në gjendje të përshtatshme për përdorim.

5.2 Qiramarrësi detyrohet të mirëmbajë ambientet dhe të riparojë çdo dëmtim të shkaktuar nga veprimtaria e tij.

### Neni 6 – Aspektet mjedisore dhe rregullatore

6.1 Palët deklarojnë se ushtrimi i veprimtarisë së secilës shoqëri në ambientet objekt i kësaj kontrate do të bëhet në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor dhe rregullator në fuqi.

6. Kjo kontratë qiraje nuk përbën dhe nuk kufizon bazë juridike për lidhjen e marrëveshjeve të tjera bashkëpunimi ndërmjet Palëve.

## Neni 7 – Përgjegjësia ligjore

7.1 Secila palë mban përgjegjësi të plotë administrative, civile dhe penale për veprimtarinë që ushtron.

7.2 Asnjëra palë nuk mban përgjegjësi për shkeljet ligjore të palës tjetër.

## Neni 8 – Zgjidhja e kontratës

8.1 Kontrata mund të zgjidhet:

- a) me marrëveshje të ndërsjellë;
- b) me njoftim me shkrim 60 ditë përpara;
- c) në rast shkeljeje të rëndë të kushteve të kontratës.

## Neni 9 – Dispozita përfundimtare

9.1 Çdo ndryshim i kësaj kontrate bëhet vetëm me shkrim.

9.2 Për çështjet e paparashikuara në këtë kontratë zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

9.3 Mosmarrëveshjet zgjidhen fillimisht me mirëkuptim, dhe në mungesë të tij, nga gjykata kompetente.

Kjo kontratë u hartua në dy (2) kopje origjinale, nga një për secilën palë.

QIRADHËNËSI

*Danijel Gjorky*  
*Arifjon Curri*



QIRAMARRËSI



## MARRËVESHJE PËR PËRDORIMIN E LEJES MJEDISORE – TIP B, ID 7.12/r

Sot, më datë 27 /10 / 2025, në Durrës, lidhet kjo marrëveshje ndërmjet:

**Shoqëria DEUTSCHCOLOR sha**, me seli ne Durrës Maminas VLASHAJ Autostrada Tiranë – Durrës, Zonë Kadastrale 3796, regjistruar si person juridik, me NIPT **L21326504J**, me administrator **z.Danjel Cfarku**, madhor, me zotësi te plote per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr.Personal I90714080D dhe **z.Arijan Curri**, madhor, me zotësi te plote per te vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr.Personal J50320085M

dhe

### II. QIRAMARRËSI

**Shoqëria “Chemicals & Polymers shpk”**, një shoqëri shqiptare, regjistruar në Regjistrin Tregtar, Qendra Kombetare e Biznesit, me numër identifikimi M33614202A, me adresë : Autostradac Tirane – Durrës, Maminas, Vlashaj, përfaqësuar nga administratori Z.Adi Beti, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së ID me numër personal J11130061I

Të dyja palët, më poshtë të quajtura së bashku “Palët”, bien dakord si vijon:

#### Neni 1 – Referenca e lejes

1.1 Qiradhënësi zotëron Lejen Mjedisore Tipi B, ID 7.12/r, e lëshuar nga autoriteti kompetent për ambientet dhe aktivitetet e mëposhtme:

- Veprimtaria: Prodhimi i preparateve veshese, llaqeve, bojrave dhe ngjitesve
- Vendndodhja: Durrës, Maminas, Vlashaj, Autostrada Tiranë - Durrës, Zonë Kadastrale 3796
- Kufizimet: Leja ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi
- Detyrimet: Leja zbatohet sipas detyrimeve dhe rregulloreve të legjislacionit në fuqi

1.2 Leja mbetet në pronësi të Qiradhënësit dhe nuk transferohet, nuk delegohet dhe nuk krijon të drejta pronësie për Qiramarrësin.



## Neni 2 – Qëllimi dhe përdorimi

2.1 Qiramarrësi mund të përdorë ambientet dhe pajisjet për ushtrimin e aktivitetit të autorizuar nga Leja Tip B, ID 7.12/r, vetëm për veprimtaritë e lejuara.

2.2 Çdo aktivitet jashtë kornizës së lejes kërkon marrëveshje të shkruar me Qiradhënësin dhe përputhje me procedurat ligjore për ndryshim ose plotësim të lejes.

2.3 Përdorimi i ambientit nuk duhet të pengojë, cenojë ose kufizojë aktivitetin e Qiradhënësit dhe duhet të respektojë të gjitha standardet teknike dhe mjedisore.

## Neni 3 – Përgjegjësitë e palëve

3.1 Qiramarrësi është përgjegjës për respektimin e kushteve të lejes, legjislacionit mjedisor, dhe detyrimeve për mbrojtjen e mjedisit.

3.2 Qiradhënësi mbikëqyr zbatimin e kushteve të lejes për ambientet që përdoren nga Qiramarrësi dhe mban përgjegjësi për pajisjet dhe kapacitetet e autorizuar.

3.3 Secila palë mban përgjegjësi të veçantë dhe individuale për çdo shkelje ligjore, teknike ose mjedisore të aktivitetit të vet.

## Neni 4 – Monitorimi dhe raportimi

4.1 Qiramarrësi pranon të bashkëpunojë me Qiradhënësin për çdo monitorim ose raportim mjedisor të kërkuar nga autoritetet kompetente.

4.2 Të dhënat e monitorimit dhe raportimit përdoren për respektimin e kushteve të lejes dhe për dokumentimin e aktivitetit mjedisor.

## Neni 5 – Ndryshime dhe plotësime të lejes

5.1 Çdo ndryshim i aktivitetit që kërkon modifikim të lejes do të rregullohet me marrëveshje të shkruar ndërmjet Palëve dhe përmes procedurave ligjore pranë autoriteteve kompetente.

5.2 Marrëveshja nuk kufizon të drejtën e Palëve për të lidhur marrëveshje të tjera bashkëpunimi ose teknike.

## Neni 6 – Afati



6.1 Kjo marrëveshje ka të njëjtin afat si kontrata e qirasë midis Palëve dhe mund të rinovohet me marrëveshje të shkruar.

Neni 7 – Dispozita të përgjithshme

7.1 Çdo mosmarrëveshje zgjidhet fillimisht me mirëkuptim, dhe në mungesë të tij, nga gjykata kompetente sipas legjislacionit shqiptar.

7.2 Kjo marrëveshje është pjesë e marrëdhënies kontraktuale midis Palëve dhe nuk zëvendëson lejen mjedisore, por krijon bazë ligjore për përdorimin e përbashkët të ambientit në përputhje me lejen.

QIRADHËNËSI

Danjel Garku  
Arijan Cerri



QIRAMARRËSI

